

ABSTRAKTI

Punimi i gradës master me temë “ Analizimi i derivateve të naftës dhe ndikimi në mjedis” fokusohet në hulumtimin e cilësisë së derivateve të naftës në vende të ndryshme të Republikës së Kosovës në vite të ndryshme. Më konkretisht do të analizojmë importin e Vajit për ngroje i cili import ishte i thekësuar në sezonin e dimërit ku reflekton që kemi pasur ndotje të madhe që tejkalonte normat e standardeve. Për të plotësuar qëllimin, gjithashtu, studimi synon të paraqesë problemet ekonomike në lidhje me krizën globale që vinte duke u reduktuar për çdo vit më shumë dhe importuesit hulumtonin cilësinë më të lirë të derivateve si për vaj ngrohje gjithashtu edhe për dizel. Gjithashtu punimi trajton sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë trajtimit të derivateve që është specifikuar procedura e mostrimit.

Metodologjia e përzgjedhur në hulumtim përfshin një qasje të kombinuar cilësore dhe rekomanduese. Qasja cilësore është bazuar në analizën regresive të marrjes së mostrave në vende të ndryshme në Republikën e Kosovës në terminale doganore dhe pika shitëse me pakicë të pranishme në Kosovë për të përkjet cilësisë duke pasqyruar të dhëna nga viti 2015 në importin e vajit për ngrohje e deri tek importi i derivateve benzinë dhe dizel për vitin 2021. Kjo analizë është mjaft e dobishme pasi tregon se dhënia e lejeve për import të derivateve që kërkonin rafinim të mëtutjeshëm ishte e gabuar nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, pasi që rafinimi i derivateve është një fushë e gjerë në vete dhe kërkon kushte dhe investime të mëdha dhe me kuptimin e plotë të fjalës mund të themi që për subjektet në vendin tonë janë të paarrtshme. Studimi është një kërkim sistematik pasi për të arritur tek gjetjet dhe përfundimet u procedua nëpërmjet ndjekjes së hapave në vijim: (1) përcaktimi i problemit, (2) shqyrtimi i literaturës, (3) formulimi i hipotezave, (4) grumbullimi i të dhënave, (5) analiza e gjetjeve, (6) nxjerrja e përfundimeve.

Studimi garanton vlefshmëri të brendshme dhe të jashtme të rezultateve të gjeneruara nga analizat cilësore statistikore në përputhje me dizenjimin e studimit dhe me metodat e përgjedhura. Vlefshmëria e brendshme garantohej pasi të gjitha gjetjet dhe përfundimet e studimit janë rezultat i analizave statistikore si: (1) frekuencat e vlerave të variablave; (2) analiza korrelacionale dhe (3) analiza regresive e variablave të përcaktuar të studimit dhe nuk kanë lidhje me variabla të tjerë.

Studimi siguron besueshmëri të brendshme dhe të jashtme të gjetjeve dhe përfundimeve duke ofruar përfundime konsistente dhe të qëndrueshme. Besueshmëria e brendshme sigurohet nga fakti që në rast se studimi do të përsëritet në të njëjtat kushte apo kontekste, atëhere do të arriheshin pothuajse të njëjtat rezultate dhe përfundime.

Sektori i karburanteve është një nga sektorët me qarkullimin më të madh të parasë në Kosovë (Doganat e Kosovës, 2011). Parë nga ky këndvështrim, studimi paraqiti shumë sfida për tu realizuar, sidomos në zhvillimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave me konsumatorët apo përdoruesit e karburanteve.

[1]